



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU
ENERGY REGULATORY OFFICE



**PARIMET PËR PËRCAKTIMIN E TARIFAVE PËR SHFRYTËZIMIN E SISTEMIT TË
SHPËRNDARJES DHE TAKSAVE TË KYÇJES**

Prishtinë, Janar 2017



Pjesa I – Dispozitat e përgjithshme	3
Neni 1 - Qëllimi dhe fushëveprimi	3
Neni 2 - Përkufizimet	3
Pjesa II – Parimet e përbashkëta	4
Neni 3 - Mos diskriminimi dhe pasqyrimi i kostos	4
Neni 4 - Thjeshtësia dhe transparenca	5
Pjesa III – Metodologjia për përcaktimin e tarifave për sistemin e shpërndarjes	6
Neni 5 - Metodologjia për përcaktimin e tarifave	6
Neni 6 - Baza e përcaktimit të tarifave	6
Neni 7 - Ndarja e kostos për shfrytëzim të sistemit	7
Neni 8 - Kostot e mbulueshme	7
Neni 9 - Oferta e kushteve për shfrytëzim të shërbimeve të sistemit	8
Pjesa IV – Kyçja në sistem	9
Neni 10 - Metodologjia për përcaktimin e taksave të kyçjes	9
Neni 11 - Kyçja e gjeneratorit	10
Neni 12 - Taksat për kyçje	10
Neni 13 - Përcaktimi i taksave për kyçje	11
Neni 14 - Oferta e kushteve për kyçje	11
Pjesa V - Dispozitat kalimtare dhe përfundimtare	13
Neni 15 - Dispozitat kalimtare	13
Neni 16 - Gjuha zyrtare	13
Neni 17 - Ndryshimi	13
Neni 18 - Shfuqizimi	13
Neni 18 - Interpretimi	13



Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji sipas autoritetit të dhënë me nenin 9, paragrafi 1 nënparagrafi 1.7, nenin 15 paragrafi 1.5, nenin 25, nenin 26 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1, nenin 47 paragrafi 3 nënparagrafin 3.3 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr 05/L-084), dispozitat e nenit 28 paragrafi 8 të Ligjit për Energjinë Elektrike (Ligji Nr 05/L-085), në seancën e mbajtur me datë 18.01.2017, miratoi:

PARIMET PËR PËRCAKTIMIN E TARIFAVE PËR SHFRYTËZIMIN E SISTEMIT TË SHPËRNDARJES DHE TAKSAT E KYÇJES

PJESA I – DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi dhe fushëveprimi

1. Parimet mbi të cilat OSSH duhet të hartojë “Metodologjinë për përcaktimin e tarifave për shfrytëzim të sistemit të shpërndarjes”.
2. Parimet mbi të cilat OSSH duhet të hartojë “Metodologjinë për përcaktimin e taksave për kyçje në sistemin e shpërndarjes”.
3. Metodologjitë e përcaktuara në paragrafin 1 dhe 2 të këtij neni pas hartimit të tyre do të dërgohen në ZRRE për aprovim.
4. Parimet duhet të jenë në përputhje me Kushtet e përgjithshme të furnizimit me energji, dhe me Rregullën për vendosjen e të hyrave të lejuara maksimale të operatorit të sistemit të shpërndarjes të nxjerrura nga ZRRE.

Neni 2

Përkufizimet

1. Shprehjet e përdorura në këtë dokument kanë kuptimin si në vijim:
 - 1.1 “Aplikuesi (parashtruesi i kërkesës)” nënkupton një person fizik apo juridik i cili kërkon nga OSSH-ja, që të bëjë kyçjen e re apo për të modifikuar kyçjen ekzistuese në rrjetin e shpërndarjes;
 - 1.2 “Kyçje e thellë” nënkupton se parashtruesi i kërkesës do të ofroj me shpenzimet e veta apo do të paguaj kostot e aseteve të nevojshme për kyçje në pikën më të afërt të përshtatshme të kyçjes në sistemin ekzistues të shpërndarjes, plus çfarëdo kostosh indirekte që shkaktohen nga punë të ndërlidhura me përforsimin, zgjerimin apo rikonfigurimin e rrjetit ekzistues e të cilat shkaktohen si pasojë direkte e operimit të pikës së kyçjes;



- 1.3 “Kapaciteti efektiv” nënkupton kapacitetin total në secilën pikë të rrjetit i cili është në dispozicion për t’u shfrytëzuar nga shfrytëzuesit pa cenuar kufizimet teknike të operimit të rrjetit. Mund të klasifikohet duke iu referuar çfarëdo kriteri teknik përkatës apo standardeve në fuqi duke përfshirë por duke mos u kufizuar në, kapacitetin aktual të bartjes, kapacitetin e lidhjes së shkurtër, kufijtë e tensionit apo kufijtë e stabilitetit;
 - 1.4 “TU” ose “tensioni i ulët” nënkupton tensionin i cili nuk tejkalon 1000 Volt të tensionit të ndryshueshëm;
 - 1.5 “TL” nënkupton tensioni i shpërndarjes më i lartë se 1000 Volt të tensionit të ndryshueshëm;
 - 1.6 “Kuçje e cekët” nënkupton se aplikuesi do të ofroj me shpenzimet e veta apo do të paguaj vetëm ato kosto që shkaktohen nga krijimi i një kuçjeje të re në pikën më të afërt të përshtatshme të rrjetit ekzistues të shpërndarjes të përcaktuar nga operatori i sistemit të shpërndarjes;
 - 1.7 “Taksa standarde për kuçje” nënkupton taksa që kërkohet nga aplikuesi e cila është llogaritur për të pasqyruar koston mesatare për krijimin e kuçjes të ngjashme për atë kategori;
 - 1.8 “Shfrytëzuesi” nënkupton siç është përcaktuar në Kodin e shpërndarjes.
 - 1.9. “OSSH” nënkupton Operatori i Sistemit të Shpërndarjes;
2. Të gjitha shprehjet tjera të përdorura në këtë dokument kanë kuptimet që janë përcaktuar me Ligjin për Rregullatorin e Energjisë, Ligjin për Energjinë, Ligjin për Energjinë Elektrike.

PJESA II – PARIMET E PËRBASHKËTA

Neni 3

Mos diskriminimi dhe pasqyrimi i kostove

1. Metodologjitë për përcaktimin e tarifave dhe taksave të paraparë në Nenin 2 më lartë, OSSH duhet të ngarkojë ose ofron të ngarkojë me çmime cilindo konsumator për shfrytëzim të sistemit apo ndonjë kuçjeje , të cilat:
 - a) nuk janë diskriminuese dhe të ndryshme në aspektin material dhe teknik në mes të konsumatorëve të cilët parashtrajnë kërkesë për shërbim të ngjashëm; dhe
 - b) pasqyron, në masë të arsyeshme, kontributin që jep konsumatori i tillë për koston e përgjithshme të ofrimit të shërbimit të kërkuar.



2. Pa marrë parasysh kushtin e përgjithshëm të pasqyrimin të kostos në strukturën e tarifave dhe taksave, OSSH mund të përcaktojë taksë mesatare apo të standardizuara për kyçje apo tarifa për shfrytëzim të shërbimeve të sistemit nga cilado kategori të shfrytëzuesve, si në vijim:
 - a) shfrytëzuesit përbrenda asaj kategorie, bazuar mbi karakteristikat e kërkesës së tyre, në kuptim të gjerë janë të ngjashëm për nga kostot të cilat i shkaktojnë OSSH-së (duke marrë parasysh vëllimet relevante, faktorët e ngarkesës, formën e ngarkesës, kushtet e ndërprerjes, lokacioni i stabilimenteve në të cilat kryhen shërbimet, data dhe kohëzgjatja e ndonjë marrëveshjeje mbi sistemin si dhe çfarëdo informatash tjera relevante);
 - b) çaktimi i çmimit specifik për shfrytëzuesit përbrenda asaj kategorie do të çonte në kosto më të mëdha administrative për OSSH-në pa ndonjë përfitim material të kompensueshëm për shfrytëzuesit sa i përket transparencës; dhe
 - c) Çmimi mesatar nuk do të shkaktojë ndonjë barrierë për sa i përket konkurrencës.

Neni 4

Thjeshtësia dhe transparencë

1. Tarifat dhe Taksat duhet të jenë të thjeshta, transparente dhe të parashikueshme.
2. Tarifat dhe Taksat duhet të reflektojnë nevojën për optimizim të shfrytëzimit të rrjetit dhe të pasqyrojnë shpenzimet e shkaktuara për shfrytëzim të sistemit dhe kyçjeve.
3. Tarifat dhe Taksat duhet të marrin parasysh zhvillimet e ardhshme në strukturën e sektorit të energjisë elektrike dhe të lejojnë rregullim më të sofistikuar krahas zhvillimit të tregut.



PJESA III – METODOLOGJIA PËR PËRCAKTIMIN E TARIFAVE PËR SHFRYTËZIMIN E SISTEMIT TË SHPËRNDARJES

Neni 5

Metodologjia për përcaktimin e tarifave

1. Metodologjia për përcaktimin e tarifave duhet t'u mundësojë shfrytëzuesve të sistemit që të bëjnë një vlerësim të arsyeshëm mbi tarifën e aplikueshme për shfrytëzim të sistemit të shpërndarjes dhe duhet të përfshijë:
 - a) Bazën mbi të cilën do të llogariten tarifën për shfrytëzim të sistemit të shpërndarjes;
 - b) Bazën mbi të cilën do të bëhen tarifën e veçanta për kapacitetin në nivelet e ndryshme të tensionit në sistemin e shpërndarjes;
 - c) Listën e çfarëdo takse që mund të kërkohet për ofrimin dhe instalimin e njehsorëve, përfshirë njehsorët kontrollues, apo ndonjë impiant elektrik në pikat hyrëse apo dalje, të cilat ndihmojnë dhe janë të domosdoshme për lejimin e shfrytëzimit të sistemit dhe për mirëmbajtjen e njehsorëve dhe impianteve të tilla;
 - d) Kriteret mbi të cilat merret vendimi i OSSH-së për të refuzuar qasjen në sistem, të cilat duhet të jenë objektive, dhe teknikisht e ekonomikisht të arsyetuara.

Neni 6

Baza e përcaktimit të tarifave

1. Në përcaktimin e tarifave për shfrytëzuesit e përdorimit të sistemit sipas paragrafit 1 të Nenit 5, OSSH duhet të merr parasysh kostot afatmesme të mirëmbajtjes së një sistemi të sigurt dhe të besueshëm në mënyrë që të përmirësohet parashikueshmëria, stabiliteti dhe pasqyrimi i çmimeve në aspektin afatgjatë.
2. Metodologjia për përcaktimin e tarifave për shfrytëzim të sistemit, duhet të merr parasysh kostot afatgjate, marginale, kostot e shmangura të rrjetit që shkaktohen nga gjenerimi i shpërndarë dhe nga masat për menaxhimin e anës së kërkesës.



Neni 7

Ndarja e kostos për shfrytëzim të sistemit

1. Metodologjia duhet të përmbajë parimet vijuese:
 - a) OSSH duhet të mbulojë kostot fikse përmes një koeficienti prej 0% ndaj gjenerimit dhe 100% ndaj kërkesës – (përmes tarifës për kapacitet);
 - b) OSSH duhet të mbulojë kostot variabile për shfrytëzim të rrjetit përmes tarifave për energji- (përmes tarifës për energji);
 - c) Tarifat duhet të përcaktohen në mënyrën e cila mundëson reflektimin e kostos për ofrimin dhe mirëmbajtjen e sistemit të shpërndarjes, të disponueshëm në nivele të ndryshme të tensionit;
 - d) Shfrytëzuesit nuk duhet të paguajnë për kostot kapitale, operative apo të mirëmbajtjes në lidhje me asetet të cilat nuk i shfrytëzojnë;
 - e) Tarifat duhet të pasqyrojnë kostot që i shkaktohen, ose që vlerësohet se i shkaktohen sistemit nga shfrytëzuesi apo nga klasa e shfrytëzuesit në kohën e pikut (kërkesës më të lartë) në sistem.

Neni 8

Kostot e mbulueshme

1. Deri në përmasat e të cilave kostoja e tillë mund t'i ngarkohet shfrytëzuesit (ose në rast të tarifave mesatare, një kategori të shfrytëzuesve), tarifat për shfrytëzim të sistemit mund të përcaktohen për të mbuluar, si në vijim:
 - a) Kostot kapitale dhe të punës për mirëmbajtjen e një sistemi të sigurt dhe të besueshëm, në përputhje me standardet kombëtare në fuqi, që vlejnë për transportin e energjisë elektrike nga pika hyrëse e shfrytëzuesit deri te pika dalëse, dhe atë deri në masën ku këto kosto nuk mund të rikthehen nga ndonjë tarifë apo taksë tjetër;
 - b) Kostot e mirëmbajtjes së tensionit dhe frekuencës në kuadër të kufijve shtetëror në fuqi;
 - c) Kostot e arsyeshme të humbjes në shpërndarje (si teknike ashtu edhe komerciale) në formën e furnizimeve shtesë të nevojshme për t'i mbuluar këto humbje në shpërndarje (siç përcaktohen nga Rregullatori);
 - d) Kostot e ofrimin, instalimit dhe mirëmbajtjes së njehsorëve relevant, deri në masën ku këto kosto nuk rikthehen nga ndonjë tarifë apo taksë tjetër; dhe
 - e) Çfarëdo kosto tjetër të cilën, kohë pas kohe, Rregullatori mund ta aprovojë si të mbulueshme përmes sistemit të tarifave ashtu siç është përcaktuar në Rregullën për vendosjen e të hyrave të lejuara maksimale të operatorit të sistemit të shpërndarjes.



Neni 9

Oferta e kushteve për shfrytëzim të shërbimeve të sistemit

1. Në kërkesën e parashtruar nga ndonjë konsumator, OSSH duhet të ofrojë marrëveshje për ofrimin e shërbimeve të shfrytëzimit të sistemit.
2. Oferta në paragrafin 1 i këtij neni duhet të bëhet jo më vonë se tridhjetë [30] ditë kalendarike pas pranimit të kërkesës për kyçje në rrjetin e tensionit të ultë dhe nëntëdhjetë (90) ditë kalendarike për kyçje në rrjetin me tension të mesëm.
- 3 .Oferta për të vënë në dispozicion shfrytëzimin e shërbimeve të sistemit duhet të përcaktojë:
 - a. Pikën e kyçjes,
 - b. Kapacitetin në disponim,
 - c. Të gjitha shërbimet tjera të cilat mund të kërkohen me kërkesë, dhe
 - d. Çmimet që duhet të paguhen për shërbimet e tilla.
4. Çfarëdo marrëveshje apo ofertë e bërë nga OSSH-ja duhet të jetë në pajtim me Ligjet e Kosovës, Kodin e shpërndarjes, Licencën apo ndonjë Rregull tjetër të lëshuar nga Rregullatori.



PJESA IV – KYÇJA NË SISTEM

Neni 10

Metodologjia për përcaktimin e taksave të kyçjes

1. Metodologjia e përcaktimit të taksave duhet të përgatitet në mënyrë që t'i mundësojë shfrytëzuesve të sistemit që të bëjnë një vlerësim të arsyeshëm mbi taksat e aplikueshme të kyçjes.
2. Metodologjia e përcaktimit të taksave duhet të përfshijë:
 - a) forma e ekzemplarëve ku janë të cekura materialet e nevojshme për kyçje dhe çmimet e materialeve (përfshirë koston për kryerjen e punëve dhe ofrimin dhe instalimin e linjave elektrike, impianteve apo njehsorëve), të cilat mund të kërkohen për qëllime të kyçjeve (në pikat hyrëse dhe dalëse) të sistemit të shpërndarjes për të cilat mund të paguhet taksa për kyçje dhe, sipas mundësisë, përfshijnë taksa indikative kundrejt çdo pike të cekur në listë ose (nëse kjo nuk është e mundur) bazën mbi të cilën këto taksa do të llogariten;
 - b) bazat mbi të cilën do të llogariten taksat kundrejt zgjerimit apo përforsimit të sistemit të shpërndarjes të cilën OSSH-ja vlerëson, në mënyrë të arsyeshme, se janë të domosdoshme për t'i ofruar një kyçje parashtruesit të kërkesës pa rrezikuar stabilitetin apo sigurinë e sistemit, apo cilësinë e furnizimit të shfrytëzuesve ekzistues të sistemit;
 - c) bazën mbi të cilën do të llogariten taksat ku sigurimi i linjave elektrike apo impiantit që duhet të instalohen janë të kapacitetit më të madh sesa që nevojitet për nevoja të parashtruesit të kërkesës;
 - d) bazën mbi të cilën do të llogariten taksat për mirëmbajtje dhe riparim të linjave të energjisë elektrike, impiantit apo njehsorëve të instaluar për qëllime të sigurimit të kyçjes;
 - e) bazën mbi të cilën do të llogariten taksat në raport me de-energizimin e kyçjes së konsumatorit, çkyçjen nga sistemi i shpërndarjes të OSSH-së dhe largimin e linjave elektrike, impiantit dhe njehsorëve pas çkyçjes.
 - f) kriteret mbi të cilat merret vendimi i OSSH-së për të refuzuar qasjen në sistem, të cilat do të jenë objektive dhe teknikisht e ekonomikisht të arsyeshme.
3. Për t'iu shmangur dyshimit, në rastet kur asetet janë paguar nga kontributet e konsumatorit për koston e kyçjes, Baza e Rregulluar e Aseteve nuk do të përfshijë kontributet e konsumatorëve.
4. Metodologjia duhet të përfshijë një listë të të gjitha informatave të kërkuara për kyçje në sistemin e shpërndarjes, përfshirë edhe formularët të cilët parashtruesit e kërkesës duhet t'i plotësojnë. Në rast të kyçjeve komplekse, OSSH mund të kërkojë informata shtesë nga parashtruesi i kërkesës.



5. Metodologjia e aprovuar duhet të publikohet në ueb faqen e OSSH-së dhe duhet të jetë lehtësisht e qasshme, ndërsa kopjet fizike duhet t'iu vihen në dispozicion pa pagesë parashtruesve të kërkesave të cilat nuk kanë qasje në ueb faqe zyrtare.

Neni 11

Kyçja e gjeneratorit

1. Aplikuesi për kyçje të gjeneratorit të ri apo rritjes së kapacitetit të kyçjes për gjenerimin ekzistues, duhet të paguajnë taksa për kyçje të thellë. Këto taksa duhet të përcaktohen në atë mënyrë që të mbulojnë kostot direkte për sigurimin e kyçjes në pikën më të afërt të përshtatshme në sistemin e shpërndarjes, përfshirë edhe matjet dhe transformatorët për ngritje, të domosdoshme për të mundësuar kyçjen, së bashku me koston e përforcimit dhe të rikonfigurimit të sistemit të shpërndarjes.
2. OSSH-së i lejohe të kërkojë pagesë, sipas Metodologjisë së Taksave për Kyçje e cila do të miratohet nga Rregullatori, me qëllim të mbulimit të kostove që kanë të bëjnë me vlerësimin e kërkesës së parashtruar nga gjeneratorët për kyçje në sistemin e shpërndarjes.

Neni 12

Taksat për kyçje

1. Për konsumatorë të rinjë të TU, duhet të përcaktohen taksat standarde të kyçjes për të mbuluar kostot mesatare të ndërprerjes së shërbimit dhe matjes. Parashtruesi i kërkesës duhet të paguajë taksën standarde ku pika matëse për konsumatorin nuk është më larg se [50] metra nga pika më e afërt e përshtatshme e kyçjes në sistemin e shpërndarjes.

Taksat e OSSH-ë për kyçje duhet të përcaktohen në bazë të:

1.1 Rikthimi i koston për kyçje të cekët (ngarkesat standarde)

- a. pika matëse e një konsumatori të TU nuk është më larg se 50 metra nga pika më e afërt e përshtatshme për kyçje në sistemin e shpërndarjes,
- b. një ngarkesë e re apo rritja në ngarkesë nuk tejkalon 3% të kapacitetit ekzistues efektiv në pikën e kyçjes në rrjetin e shpërndarjes, ose
- c. kyçja parashihet në Planin për zhvillim të shpërndarjes.

1.2 Rikthimi i koston për kyçje të thellë (taksat jo-standarde)

- a) për të gjithë konsumatorët që nuk janë në TU.



- b. një ngarkesë e re apo rritja në ngarkesë tejkalon 3% të kapacitetit ekzistues efektiv në pikën e kyçjes në rrjetin e shpërndarjes, dhe
- c. kyçja nuk është paraparë në Planin zhvillimor të OSSH-së.

Neni 13

Përcaktimi i taksave për kyçje

1. OSSH pas hartimit të Metodologjisë për përcaktimin e taksave për kyçje e dërgon për aprovim te Rregullatori në përputhje me Rregullën për vendosjen e të hyrave të lejuara maksimale të operatorit të sistemit të shpërndarjes dhe këto parime.
2. Sa më shpejtë të jetë e mundur pas aprovimit të Metodologjisë, OSSH duhet të parashtrojë për aprovim Rregullatorit deklaratën e taksave të tij për kyçje të llogaritura në përputhje me Metodologjinë në fuqi.
3. OSSH-ja duhet t'i parashtrojë një deklaratë të taksave të saj Rregullatorit për aprovim (nëse propozohet ndryshim i taksave apo jo) të paktën një herë në vit.
4. Taksat nuk hyjnë në fuqi para se të aprovohen nga Rregullatori. Rregullatori do t'i aprovoj taksat apo do të ofroj arsye për mos aprovimin e tyre brenda 60 ditëve kalendarike nga data e dërgimit të taksave të tilla te Rregullatori.

Neni 14

Oferta e kushteve për kyçje

1. Në rastet kur OSSH ka pranuar kërkesë formale për kyçje me të gjitha informatat e nevojshme sipas Metodologjisë së aprovuar për përcaktim të taksave, ai jep ofertë formale për të kyçur parashtruesin e kërkesës brenda afateve kohore të parapara me Rregullën për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji. Me kërkesë të konsumatorit për një kyçje të re apo të modifikuar, OSSH-ja duhet të ofrojë një pro-faturë indikative dhe jo-obliguese për të ndihmuar konsumatorin që të hartojë buxhetin lidhur me kostot financiare të këtij projekti.
2. Oferta formale duhet të përmban datën deri kur do të përfundojnë punët e kyçjes.
3. Në rastet kur OSSH-ja dhe parashtruesi i kërkesës pajtohen, oferta formale mund të përmbajë kushtet për pagesat e interesit për moskryerjen nga cilado palë të punëve të domosdoshme apo të ofrojnë pëlqime të domosdoshme e të cilat çojnë në vonesa dhe kosto për palën tjetër.
4. Çfarëdo pro-fature indikative e përgatitur në përputhje me pikën 1 më lartë, nuk duhet të obligon OSSH-në që të:



- a) bëjë studime të lokacionit apo studime të sistemit, ose
- b) të merr pro-faturë të furnitorëve për linjat, impiantet apo pajisjet e domosdoshme që mund të nevojiten për të mundësuar realizimin e kyçjes, apo për të marr ndonjë të drejtë transferimi, dhe
- c) OSSH-ja nuk duhet të obligohet që të bëjë hapat e parapara në pikat a) ose b) më lartë deri në pranimin e kërkesës formale për kyçje.

5. Çfarëdo marrëveshje apo ofertë e bërë nga OSSH-ja duhet të jetë në pajtim me Ligjet e Kosovës, Kodet teknike, Licencën e tij apo ndonjë Rregull tjetër të lëshuar nga Rregullatori.



PJESA V - DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 15

Dispozitat kalimtare

1. Brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi të këtij dokumenti i licencuari obligohet të dërgojë Metodologjinë e tarifave për shfrytëzimin e sistemit të shpërndarjes për aprovim te Rregullatori.
2. Brenda 60 ditëve nga data e hyrjes në fuqi të këtij dokumenti i licencuari obligohet të dërgojë Metodologjinë e taksave për kyçje në sistemin e shpërndarjes për aprovim te Rregullatori.

Neni 16

Gjuha zyrtare

Këto Parime janë nxjerrë në gjuhën shqipe dhe do të përkthehen në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes ndërmjet versioneve, do të mbizotërojë versioni në gjuhën shqipe.

Neni 17

Ndryshimet

ZRRE mban të drejtën që ta ndryshojë ose ta modifikojë çdo dispozitë të këtyre Parimeve pas procesit të konsultimit publik.

Neni 18

Shfuqizimi

Me këtë dokument shfuqizohen "Parimet e përcaktimit të ngarkesave të shpërndarjes" të aprovuar nga Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji në vitin 2012.

Neni 19

Interpretimi

Në rast se ka paqartësi për dispozitat e këtyre Parimeve, Bordi do të nxjerrë informacione shpjeguese.

Neni 20

Hyrja në fuqi

Ky akt hynë në fuqi me datën e miratimit nga Bordi i ZRRE-së dhe do të publikohet në faqen zyrtare të ZRRE-së.



Bordi i ZRRE-së:

Krenar Bujupi, u.d Kryesues

Arsim Janova, anëtar

Besim Sejfiqaj, anëtar